

URDHËR
Nr. 148, datë 31.3.2022

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së titullarit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për nënshkrimin e urdhrit për miratimin e Planit Kombëtar të Monitorimit të Mbetjeve për vitin 2022, zëvendësministrit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, znj. Ermira Gjeçi.

2. Në ushtrimin e kompetencës sipas këtij urdhri, zëvendësministri ndihmohet dhe mbështetet nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe struktura përgjegjëse në ministri. Zëvendësministri ndalohet të nëndelegojë kompetencat e përfituara përmes këtij akti delegimi.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Frida KRIFCA